



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
19.11.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

**Munguan: Vala Peshku dhe Blerand Stavileci.**

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues**, me këtë

### REND DITE :

#### 1. Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019.

**Valbona Makolli** dha sqarime lidhur me Propozimvendimin për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019, duke cekur se kjo është bërë sipas Ligjit për menaxhimin e financave, neni 30, paragrafi 2. Secila komunë ka të drejtën për ndarje buxhetore, por nuk guxon të kalojë 15% të investimeve kapitale. E kemi bërë në këtë formë, sepse është një pjesë e mjeteve të grantit qeveritar me i shfrytëzuar për ato projekte që nuk kanë filluar, ose kanë filluar e pagesat kanë me u bërë në janar ose në fund të vitit.

Kemi shkuar me ato projekte që nuk kanë filluar, si te shërbimet publike, te mirëmbajtja e parqeve dhe lodrave, nuk ka filluar asgjë te projektet "Tregu i ri i qytetit", "Rikonstruktimi i rrugëve: "Gazmend Zajmi", "Ali Pashë Tepelena" dhe "Karl Gega", si dhe "Sanimi i gropave, shtresave të asfaltit në rrugët e Prishtinës".

Po ashtu, kemi vlerën e cila na duhet për pagesën e pjesës së dytë të IMN "Kosova" (ish-Tjegullorja) për 20%-in, ku vjet e kemi paguar pjesën e parë, tani është pjesa e dytë.

Këto projekte për të cilat i kemi marrë këto mjete, nuk është se nuk kanë me u realizuar këto projekte ose nuk kanë filluar, mirëpo një pjesë kanë filluar me u paguar dhe një pjesë janë nga të hyrat vetanake.

**Halim Halimi** tha se nëse e shikojmë ligjërisht, d.m.th. është ajo, siç tha drejtoresha, se Komuna ka të drejtë të bëjë rregullimin e ndarjes buxhetore sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Nëse e analizojmë, atëherë, fatkeqësisht, pse nuk janë realizuar ato projekte ku do të merren ato mjete, pse nuk kanë filluar të realizohen, a nuk kemi nevojë për tregun e ri të qyteti, a nuk kemi nevojë për parqe, lodra të fëmijëve, të merren prej rrugëve, ndërtimit të rrugëve, sanimit të gropave etj.?!

Me keqardhje po them, Komuna nuk ka planifikuar dhe nuk ka menaxhuar mirë, përndryshe nuk kishte ardhur deri te kjo ndarje buxhetore. Çështja e IMN "Kosova" (ish-Tjegullorja), nuk është e sotshme, se ne e kemi ditur që kemi me paguar me këste këtë shumë parash.

**Agim Gashi** kërkoi nga drejtoresha, që deri në mbledhjen e Kuvendit, me pas një pasqyrim më detal të shpërndarjes së subvencioneve, transferove, se janë dhënë vetëm në vija të trasha e nuk janë specifikuar. Për të qenë raportimet e sakta, në pasqyrime është mirë me qenë gjithmonë kodet. Ju si Drejtori e Financave, është mirë me i rekomanduar drejtorit, që përgatitjet për punë sezonale me i bërë në fund të vitit buxhetor, për fillimin e vitit të ardhshëm buxhetor këto nuk implementohen, për arsye të vonesave që paraqiten në prokurim dhe procedurat delikate në prokurim. Për këtë arsye mbesin shuma të mëdha parash, andaj duhet me vetëdijesuar këtë bashkëpunim, me ngritur shkallë tjetër bashkëpunimi në mes drejtorive, sepse është shkallë emergjente. Nëse nuk ndryshon kjo praktikë, ne gjithherë kemi me u befasuar me këto veprime.

**Sami Boroci** tha se te pjesa e planifikimit të buxhetit, shihet se në raporte financiare vazhdimisht po kemi mungesë të realizimit të projekteve, po kemi bartje, tepricë buxhetore! Kjo është duke u bërë për shkak të planifikimit të keq të buxhetit. Kjo është përgjegjësi direkt e drejtorëve për drejtoritë që ata i udhëheqin.

Është fatkeqësi për Prishtinën nëse projektet e mëdha shtyhen çdo vit dhe nuk implementohen. Ka filluar të bëhet shqetësuese mënyra se si po tepron buxheti, si po menaxhohet buxheti i Prishtinës, andaj ne duhet kërkuar më shumë përgjegjësi në momentin që na sillet buxheti i vitit të ardhshëm, sepse nuk mundet vetëm me i qitur disa tabela e me thënë këto janë projekte, se vërtetë është mos planifikim, për atë arsye po na tepron buxheti, nuk po realizohen projektet dhe po kemi ngecje.

**Eman Rrahmani** shprehu shqetësimin për Tregun e qytetit, për gjendjen në të cilën janë duke punuar ata qytetarë. Ai treg nuk i plotëson as kushtet minimale, aty ka rrezik edhe për epidemi. Në një situatë normale, ai treg është dashur të mbyllej menjëherë.

Njëherësh ai parashtroi pyetje se a ka mjete të tjera të grantit qeveritare që nuk do të mund të shfrytëzohen, për shkak se vitin e kaluar afër 2 milionë euro na i ka marrë Qeveria që nuk kanë mundur me u investuar për shkak të keqmenaxhimit të drejtorëve, siç tha parafolësi, por unë them të kryetarit, se ai është përgjegjësi kryesor, se ai ka me i menaxhuar drejtorët,

kështu që nëse ka mjete të tjera, më mirë është që Komuna me i kryer këto obligime, borxhe që i ka, sesa me i humbur ato mjete.

**Fadil Gashi** u shpreh i pajtimit me mendimin e zotëri Borocit, që ceku se përgjegjës direkt për mos realizimin e projekteve, tepricës buxhetore, janë drejtorët, se kjo është duke u bërë për shkak të planifikimit të keq të buxhetit, kështu që kryetari duhet të ndër marrë masa ndaj drejtorëve që nuk punojnë dhe nuk japin kurrfarë përgjegjësie për punë.

Ai propozoi që gjithsesi me qenë drejtorët prezentë në seanca, sidomos kur është pika e fundit e seancës "Pyetje dhe përgjigje".

**Eman Rrahmani** sugjeroi që në rast se nuk janë drejtorët të pranishëm në mbledhje, mos me votuar asnjë pikë të rendit të ditës.

**Valbona Makolli** dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara, duke cekur se kodet ekonomike mundet me i shtuar, vetëm e shton një rubrikë të re për kodet dhe kjo nuk paraqet problem.

Te subvencionet, te ato që i cekët ju, ato janë në ueb-faqe dhe unë mund t'i printoj, p.sh. totalin që ekzekutojmë në drejtori dhe prej ueb-faqes së secilës drejtori, i bashkëngjis dhe i qesë në raport, por ju mundeni me hy me i shikuar, janë në detale në ueb-faqe.

**Agim Gashi** tha se në raportin vjetor duhet ta specifikoni që raporti i dhjetorit kur të silllet, është kompletë nëse është i specifikuar, se nëse është gjysmak, dalim jo serioz kur ta votojmë.

**Valbona Makolli** tha se do t'i paraqesë në raportin e dhjetorit. Këtu është dashur që kolegët e mi me ardhur dhe me shpjeguar se më mirë e dinë për drejtoritë që i udhëheqin ata.

Desha të ju informoj se te mirëmbajtja e parqeve dhe lodrave, kemi pasur një telashe me kompaninë, me procedurat e prokurimit, kanë shkua në shërbimet publike, në fund kryetari ka vendosur me shkua përmes Ndërmarrjes Publike Banesore. Ata kanë filluar diçka, por kemi të hyra vetanake që mund t'i mbulojmë ato pagesa.

**Egzon Azemi** tha se drejtoresha ka deklaruar publikisht, se një pjesë e fondeve të Drejtorisë së Parqeve ka me ia dedikuar NPB-së! Pse me ia transferuar NPB-së, kur për këtë punë është "Hortikultura". Është shumë më e natyrshme që mirëmbajtjen e parqeve me bërë "Hortikultura".

**Agim Gashi** tha se mirëmbajtjen e parqeve nuk mund ta kryejë NPB-ja, kjo mund të kryhet nga "Hortikultura", por kur "Hortikultura" t'i ndërtojë kapacitetet profesionale, sepse "Hortikultura" nuk ka specialistë përbrenda vetes që merret me krasitjen e drurëve, që merret me pastrimin fito-sanitar të parqeve, që merret me kultivimin e llojeve të drurëve karshi kushteve gjeografike dhe pozitës gjeografike që e kanë parqet tona.

**Sami Boroci** tha se te kjo pjesë nuk jam pajtuar as unë, që parqet me i mirëmbajtur NPB-ja, pak po e shoh si logjikë me e ndihmuar një ndërmarrje të caktuar dhe kjo po më bie në kundërshtim me atë, p.sh. kur e kemi subvencionuar ndërmarrjen "Sport Marketing" e kemi parë që është një ndërmarrje e cila e ka problem me qenë e vetëqëndrueshme, dhe unë pata kërkuar, i pata shkruar ekzekutivit dhe Kuvendit, dhe pata kërkuar që ndërmarrja "Sport Marketing" me i marrë në menaxhim hapësirat reklamuese. Kjo i kish mundësuar që me pasur një lloj qëndrueshmëri financiare, në mënyrë që Komuna e Prishtinës mos me pasur nevojë me subvencionuar këtë ndërmarrje, por ajo nuk është lejuar. Unë besoj se kjo është e gabuar, sepse ata nuk kanë njerëz të duhur me i mirëmbajtur ato parqe.



**Eman Rrahmani** tha se me sa e kam kuptuar dhe parë në terren, është fjala për këndet e lodrave. Lodrat që janë dëmtuar janë duke i rregulluar, dhe besoj se është shumë mirë që ia kanë dhënë kësaj ndërmarrje, sepse ka kosto shumë më të vogël, është fjala për kënde të lodrave, jo për parqe.

**Egzon Azemi** tha se në rast se i jepet një tender dikujt për ndërtimin e këndit të lodrave, ajo kompani që e fiton atë tender e ka obligim edhe mirëmbajtjen e tyre.

**Valbona Makolli** bëri një sqarim lidhur me diskutimin e zotëri Rrahmanit për grant qeveritar, janë te pagat grant qeveritar, që aty nuk mundemi me i prekur, janë te mallrat dhe shërbimet, por jemi duke bërë pagesa te investimet kapitale, pas kësaj, në fund të muajit mundemi me ditur a kanë mbetur më a jo.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore për buxhetin e vitit 2019 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta

